



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deonikarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Në bazë të nenit 8 dhe 10, paragrafi 2 dhe nënparagrafi 2.1 të Ligjit të Punës, nenit 8 paragrafi 2 të Rregullores për Marrëdhënie pune në Trepça Sh.A., nenit 22 paragrafi 3 dhe 4 i Statutit të Trepça Sh.A., Trepça Sh.A., me datë 16.09.2025 publikon këtë:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Titulli i pozitës së punës:	Laborant
Koeficienti/Paga:	620€ bruto
Nr. i kërkuar:	4
Kohëzgjatja e emërimit:	Në kohë të pacaktuar, periudha provuese 6 muaj
Data e njoftimit:	16.09.2025
Afati për aplikim:	17.09.2025 - 01.10.2025
Institucioni:	Ndërmarrja "Trepça Sh.A."
Njësia Biznesore:	Miniera me Flotacion Trepça – Stan Tërg
Vendi i punës:	Flotacion-Tunel i Parë

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Filtron dhe përgadit mostrat e ndërrimit të flotacionit dhe dromcorës;
- Kryen përgaditjen e mostrave gjeologjike;
- Kryen përgaditjen e mostrave mujore dhe 3 mujore;
- Përgadit mostrat e koncentratit të Pb dhe Zn të marrura në Kamiona (Llotat);
- Është i ngarkuar me mbarëvajtjen e marrësve të mostrave në ndërrim;
- Bashkëpunon me kryepunëtorin e ndërrimit;
- Sipas nevojës kryen edhe punë të tjera.

2. Kriteret e përgjithshme

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.

3. Kriteret e veçanta

- Të posedojë diplomë të shkollës së mesme
- Duhet të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale.

4. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit

- Aplikacioni (i cili shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);
- Deklarata nën betim (e cila shkarkohet online nga ueb-faqja e Trepça Sh.A.);

- Dëshminë e përvojës së punës profesionale;
- Dëshmi nga gjykata kompetente që dëshmon se aplikuesi nuk është i dënuar për vepër penale apo nuk është nën hetime jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- CV-Biografia;
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjet e diplomave të noterizuara mbi kualifikimin arsimor dhe / ose nostrifikimin për diplomat jashtë vendit.

5. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- a. Testimi me shkrim – 100 pikë
- b. Intervista – 300 pikë

6. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes e-mail dhe ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.”

7. Mënyra e aplikimit

- Dokumentacioni duhet të dorëzohet në zyrën e protokolit të Trepça Sh.A., në Menaxhmentin e Trepça Sh.A.-Parku Industrial në Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00-16:00.

8. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesit do të shpallen përmes ueb faqes së ndërmarrjes “Trepça Sh.A.” dhe do të njoftohen edhe në mënyrë elektronike. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.



 Trepça Sh.A.
 Kryeshefi Ekzekutiv

 Faton Ahmeti